

Politizimi i Asociacionit/Komunitetit

Qëllimi fillestar i deklaruar lidhur me dialogun e Brukselit ka qenë adresimi i problemeve të pazgjidhura të komunitetit Serb në Kosovë. Formimi i një asociacioni/komuniteti i komunave me shumicë Serbe është konsideruar si një mekanizëm adekuat për t'i ofruar komunitetit Serb vetëqeverisje të mjaftueshme në shumë qështje relevante – siq është edukimi, kujdesi shëndetësor, planifikimi urban dhe zhvillimi ekonomik – në zonat me shumicë Serbe. Por, pesë vite pas marrëveshjes, ky mekanizëm ende nuk është themeluar. Gjithashtu nuk është e qartë se cili duhet të jetë roli i një mekanizmi të tillë.

Këshilli për Qeverisje Gjithpërfshirëse (CIG) ka organizuar një tryezë të rrumbullakët më 20 qershor, 2018 lidhur me hapat e nevojshëm për krijimin e Asociacionit/Komunitetit. Pjesëmarrësit ishin përfaqësues të partive politike, kryetarë komunash dhe anëtarë të shoqërisë civile. Punëtorja është pjesë e një projekti më të madh lidhur me marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, projekt ky i implementuar në bashkëpunim me, dhe mbështetur nga Departamenti Federal Zvicerran për Punë të Jashtme.

Diskursi lidhur me Asociacionin/Komunitetin është politizuar dhe mistifikuar edhe para se të fillonin diskutimet mbi statutin. Disa parti politike bënë fushatë dy vite më parë për të mbledhur nënshkrime kundër formimit të Asociacionit/Komunitetit. Shumë thonë që mbledhja e rreth 200,000 nënshkrimeve nuk ka qenë e bazuar në një proces të informuar dhe substancial. Logo e pashprehur e fushatës ka qenë 'voto kundër Republikës Serbe' një entitet në Bosnje dhe Hercegovinë me territor më shumë se dyfishi i tërë Kosovës, me institucionet e veta policore, gjyqësore dhe qeveritare. Shumë thonë që paralelet ndërmjet Asociacionit/Komunitetit dhe Republikës Serbe thjeshtë nuk qëndrojnë. Fushata u karakterizua gjithashtu me retorikë nacionaliste dhe diskurs agresiv publik të shoqëruar me demonstrata.

Qëllimi primar politik i Asociacionit/Komunitetit ka qenë integrimi i të gjitha institucioneve të mbetura Serbe në Kosovë, duke përfshirë shëndetësinë, edukimin, shërbimin social (pensionet, ndihmat sociale, pagat), dhe shërbimet publike (furnizimin me ujë, mbledhjen e mbeturinave). Edhe pse sipas ligjit të Kosovës këto janë përgjegjësi komunale, negociatorët e Beogradit dhe Prishtinës në Bruksel treguan pak fleksibilitet. Përfaqësuesit qeveritar të Kosovës në atë kohë bënë me dije se formimi i Asociacionit/Komunitetit siguron që Serbia del nga Kosova, përderisa Serbët e Kosovës fitojnë një nivel vetëqeverisje në nivel lokal dhe opioni i ndarjes përfundimisht do të largohet nga tryeza.

Më poshtë mund të shihni disa nga pikat e diskutimit gjatë tryezës së CIG-ut.

- **Konflikti mes Prishtinës dhe Beogradit:** Asociacioni/komuniteti pasqyron një konflikt në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Serbët e Kosovës kanë pak ndikim në politikbërje qoftë në Kosovë apo në Serbi. Mbi të gjitha, marrëveshja e Brukselit ka qenë në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Pak në Kosovë dhe Serbi e kanë idenë se si duhet të duket Asociacioni/Komuniteti. Shumë thonë që edhe kur marrëveshja është bërë në Bruksel në vitin 2013, askush nuk ka pasur ide të qartë lidhur me këtë mekanizëm; ata thjeshtë u pajtuan për hir të pajtimit. Prishtina ofron modelin e Asociacionit aktual të komunave të Kosovës. Por shumë pyesin pse atëherë është dashur partitë të negociojnë në Bruksel për dy vite kur modeli ka ekzistuar? Palët mbesin të barrikaduara në pozicionet e vjetra.
- **Asociacioni/Komuniteti pjesë e fazës finale:** Ka shumë gjasë që Asociacioni/Komuniteti nuk do të formohet deri të arrihet një marrëveshje finale në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Asnjëra palë nuk është e interesuar ta formojë atë sipas marrëveshjes së Brukselit. Beogradi shpreson ta marrë veriun nëpërmjet një marrëveshjeje për ndarje, kështu të eliminojë nevojën për krijim të një Asociacioni/Komuniteti, apo, nëse ndarja nuk kalon, atëherë të synojë për një status autonomie substanciale për veriun, një Asociacionin/Komunitetin plus. Prishtina është duke shpresuar që Asociacioni/Komuniteti do të jetë një organizatë kordinuese e ngjajshme me statusin e një OJQ-je.
- **Roli i pavarur apo koordinues:** Polemika kryesore është kompetenca e Asociacionit/Komunitetit. Prishtina insiston që Asociacioni/Komuniteti nuk duhet të ketë asnjë kompetencë mbi komunat, dhe që komunat ruajnë kompetencat e tyre të plota dhe që Asociacioni/Komuniteti do të ketë një rol kordinues. Beogradi, në anën tjetër, insiston për një organ me kompetenca të pavarura të vendimmarrjes.
- **Ombrella politike:** Asociacioni/Komuniteti do të ruante të drejtat autonome të serbëve të Kosovës dhe të ndalojë një dominim të mundshëm të shqiptarëve mbi qështjet e komunitetit Serb. Do të shërbente si një ombrellë mbrojtëse për interesat e serbëve në Kosovë dhe gjithashtu do siguronte lidhje direkte në mes të komunitetit Serb dhe Beogradit.
- **Krahasimet joadekuate:** Asociacioni/Komuniteti shpesh është krahasuar me Republikën Serbe. Këto krahasime kanë të meta. Asociacioni/Komuniteti do të formohet sipas ligjit të Kosovës. Shqiptarët i druhen por droja nuk është arsye e mirë për vonimin e formimit të tijë. Komuniteti Serb nuk iu beson shqiptarëve prandaj iu nevojitet një institucion që ka disa kompetenca për ti mbrojtur interesat e tyre kolektive, siq janë edukimi dhe kujdesi shëndetësor.
- **Ndryshimet kushtetuese:** Për ti dhënë Asociacionit/Komunitetit kompetenca ekzekutive nevojiten ndryshime kushtetuese. Ligjet ekzistuese nuk iu lejojnë komunave të delegojnë kompetencat e tyre tek një institucion tjetër. Shumë presin që Asociacioni/Komuniteti të evoluoj në diqka tjetër në fazën finale në mes të Prishtinës dhe Beogradit, vecanërisht nëse marrëveshja përfshinë ndryshime kushtetuese.
- **Krijimi i ndarjes për parandalim të dominimit:** Shumë shqiptarë argumentojnë që Asociacioni/Komuniteti ndanë komunitetin serb, duke e parandaluar të bëhet pjesë e strukturës shoqërore në Kosovë. Sidoqoftë, Serbët e Kosovës e shohin atë si mjet që do të parandalonte dominimin shqiptarë në çështjet e komunitetit serb.

- **Të drejtat e Komunitetit dhe Acqui Communautaire:** Mandati i Asociacionit/Komunitetit duhet të jetë në përputhshmëri me Acqui Communautaire dhe legjislacionin tjetër të BE-së në mënyrë që të mos shkaktojë kokëdhimbje në të ardhmen integruese të Kosovës në BE.

Ideja mbrapa marrëveshjes së vitit 2013 për formimin e Asociacionit/Komunitetit ka qenë dhënia e një autonomie komunale më të madhe serbëve të Kosovës në këmbim të integritetit të veriut të dominuar me serbë në sistemin e Kosovës, në mënyrë që të hiqet nga tryeza tema e ndarjes. Shumë në atë kohë e konsideruan si “pazarë të mirë”. Por prej atëherë pozicionet e palëve kanë ndryshuar. Duke iu përshtatur politikës vendore, negociatorët e Prishtinës dhe Beogradit kanë hezituuar në implementimin e marrëveshjes së dakorduar në vitin 2013. Katër vite më vonë, nuk ka Asociacion/Komunitet dhe vetëm integrim sipërfaqësor në veri.

Diskursi lidhur me Asociacionin/Komunitetin është bërë helmues edhe para se diskutimet rreth statutit të fillonin. Është e nevojshme që debati të çmitizohet dhe depolitizohet, duke u fokusuar ekskluzivisht në fushat dhe shkallën e përgjegjësisë që Asociacioni/Komuniteti do duhet të ketë. Vetëm një debat i tillë substancial do të paraqiste nëse Asociacioni/Komuniteti është vërtetë një kërcënim për funksionalizimin e Kosovës, apo, në të kundërtën, është në vet interesin e Kosovës përderisa do të mundësonte mbylljen e institucioneve paralele të mbetura dhe integrimin e tyre në sistemin e Kosovës.

Pjesëmarrësit

Liburn Aliu, Deputet në Parlamentin e Kosovës (Lëvizja Vetëvendosje)
Milica Andric, Analist
Ardian Arifaj, Këshilltar i Presidentit të Kosovës
Belul Beqaj, Analist
Aida Derguti, Deputete në Parlamentin e Kosovës (Partia Social Demokrate)
Arben Gashi, Deputet në Parlamentin e Kosovës (Lidhja Demokratike e Kosovës)
Bajram Gecaj, Këshilltar i Presidentit, Lidhja Demokratike e Kosovës
Dalibor Jevtic, Zëvendës Kryeministër i Kosovës
Miodrag Milicevic, Drejtor Ekzekutiv, Aktiv
Besnik Osmani, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës
Zenun Pajaziti, Deputet në Parlamentin e Kosovës (Lidhja Demokratike e Kosovës)
Lulzim Peci, Drejtor Ekzekutiv, KIPRED
Nenad Radosavljevic, Kryetar i Bordit, Rrjeti i TV stacioneve Serbe në Kosovë
Goran Rakic, Kryetar i Mitrovicës së Veriut; Kryetar i Listës Serbe
Xhelal Svecla, Deputet në Parlamentin e Kosovës (Lëvizja Vetëvendosje)
Armend Zemaj, Member of Parliament of Kosovo (Lidhja Demokratike e Kosovës)
Burbuqe Brahimi, Përfaqësuese në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse
Shpetim Gashi, Zëvendës President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse
Jean-Hubert Lebet, Ambasador i Zvicrrës në Kosovë
Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse